

Tiranë 13.03.2026

FTESË PËR OFERTË

ME OBJEKT *“Lyerje, punime elektrike dhe hidraulike për ambientet e Qendrës për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Kujdestare ,Tiranë*

Për Shoqatën SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri

1. Për Shoqatën SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri (SOS AL) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse dhe anëtare aktive e Federatës SOS Fshatrat e Fëmijëve, e përbërë nga 136 shoqata të pavarura kombëtare. Ne punojmë së bashku me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri. Që nga viti 1995, SOS Shqipëri operon në fushën e mbrojtjes sociale duke ofruar shërbime përkujdesjeje për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbime parandaluese të bazuara në komunitet për familjet në nevojë dhe fëmijët e tyre, përgatitje për largim nga kujdesi dhe shërbime mbështetëse për të rinjtë. SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në mënyrë aktive, merr pjesë në advokim dhe mbron të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve që janë në rrezik social. Ne punojmë ngushtë me vendimmarrësit, institucionet qeveritare, organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe i kushtojmë rëndësi të madhe përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve në proceset vendimarrëse.

2. Përshkrimi I Projektit

Në Shtator 2025, SOS Fshatrat e Fëmijëve, përkatësisht SOS Shqipëria, SOS Maqedonia e Veriut, SOS Ukrainë, SOS Bjellorusia dhe SOS Armenia filluan zbatimin e Projektit ***“E drejta për një familje II - Përmirësimi i disponueshmërisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së familjeve kujdestare dhe shërbimeve të bazuara në komunitet në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë’***, i cili synon të përmirësojë të drejtat e fëmijëve me fokus të veçantë në mbështetjen e shërbimit të kujdestarisë familjare dhe reformës së sistemeve të kujdesit alternativ në këto 5 vende të synuara.

Projekti financohet nga Ministria Federale Gjermane për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim dhe agjencia zbatuese është SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë.

Objektivi i projektit : Fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror ose që janë në rrezik ta humbasin atë, si dhe familjet e tyre, përfitojnë nga një sistem i kujdestarisë familjare dhe shërbime sociale të bazuara në komunitet që janë cilësore, të aksesueshme, të qëndrueshme dhe të koordinuara, të cilat promovojnë mirëqenien, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre.

Kohëzgjatja e projektit është prej 1.09.2025 - 30.04.2029

Në kuadër të këtij projekti për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e tij, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri shpall kërkesën për ofertë me objekt prokurimi: ***‘Lyerje, punime elektrike dhe hidraulike për ambientet e Qendrës për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Kujdestare, Tiranë***

Për ofrimin e këtij shërbimi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri fton të gjitha kompanitë/subjektet e interesuara në këto fushe që të paraqesin interesin e tyre brenda datës **26.03.2026** duke paraqitur ofertat financiare dhe dokumentat plotësuese nëpërmjet postës elektronike.

MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj me e-mail me subjekt “***Ofertë për prokurim Lyerje, punime elektrike dhe hidraulike për ambientet e Qendrës për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjen, Kujdestare’*** për projektin ***E drejta për një familje II - Përmirësimi i disponueshmërisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së familjeve kujdestare dhe shërbimeve të bazuara në komunitet në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë’*** dhe emrin e kompanisë që e dorëzon, deri më datë **26.03.2026** me adresë: info@soskd.org.al

Dokumentat e aplikimit duhet të përmbajnë:

1. Ofertën Financiare e cila duhet të përfshijë çmimet në Lek me TVSH. Për ofertën financiare ju lutemi, përdorni formularin e ofertës bashkangjitur kësaj Ftese për Oferte.

2. Kopje NIPT-i.
3. Ekstrakt te QKR-se.
4. Vertetim nga Tatimet për shlyerje te detyrimeve tatimore, të jetë i vlefshëm brenda 3 muajve të fundit.
5. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën një punë të ngjashme, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, vërtetuar nga kontrata te realizuara me dokumentacionin i cili duhet të përmbajë: Situacionin Përfundimtar dhe Aktin e Koalidimit.
6. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të vlefshme për kategoritë e mëposhtme dhe ti paraqesë ato:
 - N.S - 4A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to)
 - N.S - 12A (Impiante hidrosanitare)
 - N.S - 14A (Impiante të brendshme elektrike, telefoni etj.)
7. Staf te kualifikuar: (i) inxhinier elektrik pajisur me diplome dhe kontrate pune: (ii) specialist hidraulik pajisur me dëshmi kualifikimi.
8. Vertetim qe nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
9. Grafikon e punimeve.
10. Oferta duhet te jete e vlefshme për një periudhe 60-ditore nga data e fundit e dorëzimit të aplikimit.

Për çdo pyetje ose sqarim mund të na shkruani në e-mail: info@soskd.org.al

Përgjigjet e pyetjeve do të ndahen me të gjitha kompanitë që marrin pjesë në tender në version elektronik. Çdo ofertë e marrë pas datës së mbylljes së tenderit nuk do të pranohet.

Informacion teknik:

Data dhe orari përfundimtar për levrimin e materialeve	Maksimumi 10 ditë nga njoftimi për ofertën fituese dhe marrja e porosise me shkrim.
Vendi i transportit dhe montimit	SOS Fshati i Femijeve Tirane , Sauk
Tarifat e transportimit te materialeve	E përfshirë në ofertë
Monedha e tenderimit	Monedha lokale: Lek

Shërbimet mbas shitjes së produktit	Garancitë e përfshira,
Periodha e vlefshmërisë së tenderit duke filluar nga data e dorëzimit.	Jo me pak se 60 ditë
Kushtet e pagesës	Ne përputhje me kontratën. Pagesa me anë të transfertës bankare.
Tipi i kontratës	Urdhër Blerje
Personi i kontaktit për kërkesat (Vetëm kërkesa të shkruara)	SOS Fshatrat e Femijeve, Shqipëri: adresa e e-mail info@soskd.org.al

Vlerësimi i ofertave:

- Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit dhe kërkesave teknike, si dhe cilësinë e specifikimeve teknike të ofruara.
- SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.
- SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

Datë: __. __.2026

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Ofertuesi]

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit/Kompanisë _____,

Për: SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

Objekti i prokurimit **“Ofertë për prokurim Lyerje, punime elektrike dhe hidraulike për ambientet e Qendrës për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjen Kujdestare , Tiranë”**

Nr	Pershkrimi	Sasia	Njesia	Cmimi /njesi me TVSH	Totali meTVSH
LYERJE					
1.	Lyerje e ambienteve Bojë hidromat, cilesia I, Ekologjike sipas ISO 9001-2015	230	M2		
Shuma A		_____Lek			
PUNIME dhe MATERIALE ELEKTRIKE					
1.	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	300	ml		
2.	F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2	36	ml		
3	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	150	ml		
4.	F. V. kuti celsa priza 3 modulare brenda murit	30	cope		
5.	F. V. kuti celsa priza 4 modulare brenda murit	8	cope		
6.	F. v. suport kapak 3 modular	30	cope		
7.	F. v. suport kapak 4 modular	8	cope		
8.	F v kuti shperndarese brenda murit	5	cope		
10.	F v tub elektrik d=20mm	50	ml		
11.	F.V. priza shuko me nulifikim	22	cope		
12.	F.V. celsa me dy butona	2	cope		
13.	F.V. celsa deviat me 1 buton	8	cope		

14.	F.V celsa te thjeshte	6	cope		
15.	Shina bakri lidhje 30cm	2	cope		
16.	F. V. celes zile	1	cope		
17.	F.V. tapa	38	cope		
18.	F.V Automat dy polar dy modul, 16A	5	cope		
19.	F.V Automat dy polar dy modul, 25A	4	cope		
20.	F.V Automat 3 fazor kater module, 40A	1	cope		
21.	F.V.Salvavite 3 fazore, 40 A	1	cope		
22.	F.V.Celes fuqie bolieri 16 A	2	cope		
23.	Kapikorda	25	cope		
24.	Suvatim muri (riparime mbyllje kanale)	20	m2		
25.	Zmontim priza dhe Celsa	38	cope		
26.	Zmontim I automateve	10	cope		
27.	Zmontim I ndricuesve te demtuar	11	cope		
28.	F.V Ndrices Tavani, I bardhe, 30x30 cm, LED 230V, lloji I ndricimit 2000-4000K, llampa e perfshire, Klasi i energjisë: A+	14	cope		
29.	F.V Ndrices Tavani, I bardhe, 60x60 cm, LED 230V, lloji I ndricimit 2000-4000K, llampa e perfshire, Klasi i energjisë: A+	15	cope		
Shuma B		_____ Lek			
PUNIME HIDRAULIKE DHE PAJISJE HIDROSANITARE					
1.	Furnizim dhe vendosje lavamani, pozicionimi tokesor, materiali porcelan, ngjyra e bardhe, permasat 53x50 cm	1	cope		
2.	Furnizim dhe vendosje WC, pozicionimi tokesor, materiali porcelain, kapak tualeti dhe depozita e ujit e perfshire, permasat 35.5x51.5x27cm	1	cope		
Shuma C		_____ Lek			
TOTALI A+B+C (perfshire TVSH)		_____ LEK			

Oferta është e vlefshme për minimumi _____

Afati i i përfundimit të punimeve _____ dite nga marrja e porosisë.

Garancia e punimeve _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____.

Vula _____.

Shenim:

- Çmimet e ofertuara janë në monedhën Lek dhe përfshijnë TVSH, transportin e materialeve të nevojshme për punimet dhe montimin e tyre pranë ambienteve të SOS Fshatit të Femijeve, Sauk-Tirane.
- Ngjyra e bojës përcaktohet me përfaqësues të SOS FF në momentin e fillimit të punimeve.